



**"NËSE NUK KE TURP,
VEPRO Ç'TË DUASH!"**



**KOSOVA: SHTET LAIK,
SEKULAR APO ATEIST?**



**MARRËDHËNIET
E PROFETIT (A.S) ME FËMIJËT**

UDHA ISLAME

Viti 20 - Nr. 8 (234), Gusht, 2022

www.myftinia-shkoder.org

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative



MYFTINIASHKODER1990


Kur nuk ke turp vepro ç'të duash!

"Pashë disa foto në arkivin tim, foto të njëqind viteve të fundit. Ishin një turmë e madhe me gra shkodrane që dilnin nga kisha e madhe e Shkodrës. Po t'ia vendosim përpara duarsh secilit nga ju këto foto sot, do të thoni këto janë motrat tona që po dalin nga xhamia. Të gjitha të mbuluara me hixhab, atë hixhab për të cilin prej vitesh e dekadash punohet dhe cytet kundër tij dhe interesit të zhvillimit të tij në Shqipëri."



QYTETI I HUMBUR I XHAMIVE... SI I FSHEHËN GREKËT MONUMENTET OSMANE SELANIKASE?

Një foto arkivore e qytetit të Selanikut, i cili mbeti osman për më shumë se 5 shekuj dhe u njoh si "Qyteti i Minareve" për shkak të numrit të madh të xhamive.



Uzurpimi i të drejtave të turqve të krahinës së Trakës Perëndimore dhe refuzimi i autoriteteve greke për të zbatuar vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, nuk është gjë tjetër, veçse një vazhdimësi e serisë së grabitjeve të të drejtave të muslimanëve dhe persekutimit të tyre, që nga viti shpërthimit ...

(f. 4)

MYFTIU I SHKODRËS VIZITË NË BIBLIOTEKËN E QYTETIT

Ditën e hënë, më 29 gusht 2022, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari zhvilloi një vizitë në bibliotekën e qytetit, ku u prit nga drejtori i saj. z. Maxhid Cungu dhe ku së bashku zhvilluan një bisedë rreth vlerave që përmbajnë fondet e bibliotekës dhe në mënyrë të veçantë ekzemplarët e Fondit të Antikuareve.



Bashkëbisedimi u ndal edhe rreth botës së librit, trashëgimisë së dijetarëve elitarë dhe domosdoshmërisë së ruajtjes së tabanit, përballë nihilizmit dhe komplekseve...

(f. 19)



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të gjitha falënderimet e plota i takojnë vetëm Allahut të Madhëruar të gjithësisë; për të Cilin dëshmojmë se nuk ka Zot tjetër, përveç Tij, i Vetëm dhe i Pashoq. Dëshmojmë se, Hz. Muhammedi është rob dhe i dërguari i Tij. Të gjitha salavatet dhe selamet më të përzemërta ia dërgojmë sot në këtë ditë dhe çdo moment të jetës sonë, më të mirit dhe më të shtrenjtë të krijesave të Allahut, Hz. Muhamedit (a.s), që u dërgua mëshirë për të gjitha krijesat dhe që u lëndua në rrugën e përhapjes së Thirrjes Islame sa asnjë pejgamber tjetër.

Të dashur dhe të shtrenjtë, motra dhe vëllezër besimtarë!

Do ndalem tek një hadith shumë i rëndësishëm i Pejgamberit (a.s), që ka të bëjë me rëndësinë e sigurisë në jetën tonë të përditshme, për rëndësinë e shëndetit dhe rëndësinë e rizkut të pastër dhe hallall, në jetën tonë të përditshme.

Më lejoni që tek tema e sigurisë t'ju kërkoj vëmendjen drejt disa realiteteve të çuditshme, paradoksale dhe përçudnuese, me të cilat po përballemi në qytetin dhe në vendin tonë; se njeriu që nuk shikon dhe nuk merret me punët e shtëpisë së tij, por me punët e hallkut, as nuk kryen detyrimet ndaj të tjerëve dhe as nuk kryen borxhet dhe përgjegjësitë që ka ndaj vetes dhe familjes së tij! Pasi i kam parë dhe i kam kaluar nëpër filtra e filtra këto realitete, më kanë sjellë të gjitha së bashku në një hadith të madh të Pejgamberit tonë (a.s), i cili thotë: “Ajo çfarë ju ka mbërritur njerëzve nga fjalët e profecive të mëparshme, (pra ajka e profecive të hershme), është: Nëse nuk ke turp, vepro ç'të duash!”.

Çfarë lidhje ka kjo me sigurinë? Ka shumë lidhje!

“NËSE NUK KE TURP, VEPRO Ç'TË DUASH!”

Çfarë lidhje ka kjo me të sotmen?

Po të bësh një analizë sado sipërfaqësore të asaj me të cilën ne përballemi ditë për ditë, do të vish tek ky konkluzion i madh i Pejgamberit (a.s), i cili thotë: “Nëse nuk ke turp, vepro ç'të duash!”

U ndala dhe pashë disa foto në arkivin tim, foto të njëqind viteve të fundit. Ishin një turmë e madhe gra shkodrane që dilnin nga kisha e madhe e Shkodrës. Po t'ia vendosim përpara duarsh secilit nga ju këto foto sot, do të thoni këto janë motrat tona që po dalin nga xhamia. Të gjitha të mbuluara me hixhab, atë hixhab për të cilin prej vitesh e dekadash punohet dhe cytet kundër tij dhe interesit të zhvillimit të tij në Shqipëri. Dhe tani në Kosovë, paturpësia arrin deri në atë pikë, sa që edhe një komunitet fetar, që nuk e di a ka në përbërjen e tij sa një fugon anëtar, ka paturpësinë për të kërkuar ndalimin e hixhabit në shkollë! Ai komunitet më e pakta, duke shikuar në origjinën e literaturës së vet, do të gjejë imazhin e të shtrenjtës dhe të mirës Mejrem (a.s), me hixhabin e saj në kokë!

Kur nuk ke turp vepro ç'të duash!

U ndala dhe pashë pak me vëmendje një nxitje dhe një reklamim pafund të haramëve në vendin tonë dhe me mbështetjen e institucioneve kryesore të qytetit tonë thashë: “Kur nuk ke turp vepro ç'të duash!”

Pashë atë katraturë dhe paturpësi të madhe dhe të patolerueshme, për të cilën shkruajnë disa vëllezër nga Tirana, kohë pasi e kishim trajtuar në mënyrën tonë. Atje në xhaminë tonë, në kala, me mbështetjen e Bashkisë a pa mbështetjen e Ministrisë së Kulturës a pa mbështetjen e Ministrisë së Kulturës. Ata të cilët denjojnë sot dhe kanë kurajon të kthejnë mbetjet e një objekti kulti të lënë pas dore, ndërkohë që Ministria e Kulturës na thotë, sa herë që ngremë zërin, se është pronë e jona dhe nuk është pronë e saj!? Ne ia kthejmë mbrapsht Ministrisë së Kulturës, qeverisë dhe kujtdo në botë, sepse nuk mund të kthehet një xhami apo ajo çfarë ka ngelë nga ajo xhami, qoftë edhe një gur, të kthehet në diskotekë ku harbohen të devijuarit dhe të hutuarit!? Nuk mund të kthehet dhe nuk mund të pranohet

kjo. Ministria e Kulturës dhe Bashkia ta marrin mbrapsht këtë paturpësi, por kur nuk ke turp vepro ç'të duash! Unë nuk do të shkoj të bëj çfarë nuk e bëj dot, as me Ministrinë e Kulturës as me këta të Bashkisë, por do të flas, do të ngre zërin, sepse përndryshe do të duhet ta lë çallmën dhe xhyben time këtu apo ta djeg atje jashtë dhe t'u them; Es-selamu alejkum në Ditën e Gjykimit!

Kam shkruar në 2009 një libër “Rrugëtime të një hatibi”; çfarë ka aty brenda? Kam shkruar një kapitull për propagandën komuniste kundër Islamit

KAM SHKRUAR NJË KAPITULL PËR PROPAGANDËN KOMUNISTE KUNDËR ISLAMIT DHE MUSLIMANËVE NË KËTË VEND. TË GJITHA JANË TË FAKTUARA ME LITERATURËN, BURIMET E KOHËS, QAZETA, REVISTA E TË NGJASHME. SHIKONI SE ÇFARË SHKRUHET NË 67', 68', 72', MË PËRPARA, MË MBRAPA. KËTË JUA KAM THËNË EDHE HERË TË TJERA, POR ËSHTË MOMENTI ME E RIPËRSËRIT, SEPSE KUR HARROJMË TË KALUARËN TONË TË AFËRT, NDODH KJO ÇFARË NDODH DHE BËHEMI NEGLIZHENTË!

dhe muslimanëve në këtë vend. Të gjitha janë të faktura me literaturën, burimet e kohës, gazeta, revista e të ngjashme. Shikoni se çfarë shkruhet në 67', 68', 72', më përpara, më mbrapa. Këtë jua kam thënë edhe herë të tjera, por është momenti me e ripërsërit, sepse kur harrojmë të kaluarën tonë të afërt, ndodh kjo çfarë ndodh dhe bëhemi neglizhentë!

Çfarë mund të bëjmë? E ka ministria në patronazh, e ka në pronësi dhe ia jep ajo kujt të dojë? Paradoksalisht dhe padrejtësisht e ka sot në patronazh, por është e paturpshme dhe e patolerueshme që një objekt kulti të kthehet në diskotekë, ku lakuriqësia

dhe çfarë nuk duhet të përmendet në këtë mimber, është kryefjalë! “Megjithëse tek ne është likuiduar baza sociale ekonomike e fesë, ndikimi i saj ndihet sidomos në fshat...”, shkruhet këtu e pak dekada më përpara. Shikoni e njëjta pamje ka disa emra të përveçëm që shkruhen sot, kemi disa emra të tjerë të përveçëm që shkruajnë. Kjo lëvizje që po fillon nga poshtë të përhapet tregon se vetë masa të marrin pjesë aktive në formimin e ndërgjegjes së tyre socialiste. Po ndërgjegjja e sotme e këtij modeli të sotëm, si e ka emrin të dashurit e mi? Ajo atëherë e kishte socialiste, kjo e sotmja si e ka?

“Ato po e kuptojnë se paragjykimet dhe zakonet fetare ruajnë farën e degjenerimit të njeriut dhe po nuk u luftuan me guxim ashtu siç po luftohen edhe mbeturinat e tjera nuk mund të formohet njeriu i ri komunist dhe nuk mund të ecet drejtë ndërtimit të plotë të socializmit...!”.

Zëvendësoni me pak fjalë me të sotmen! Njeriu i sotëm, çfarë është ky njeriu i ri? Është modeli i atij kallëpi për të cilin Pejgamberi (a.s) thotë: “Kur nuk

ke turp vepro ç'të duash!”

Për të mos u zgjatur, disa xhami këtu në Shkodër me këtë lloj fryme u kërkuar që të kthehen nga “institucione të errëta të rrethinës në vatra të shfrenume të.... Kundër interesave të popullit, me qendër edukimin dhe argëtimin e brezit të ri...!”!? Subhanallah, e njëjta pamje, kur nuk ke turp vepro ç'të duash!

Ne po na përdhoset identiteti, personaliteti i muslimanit me sjelljen e tij, me familjen e tij dhe në lëvizjet e tij. Djali dhe vajza jonë muslimane që vijnë dhe më kërkojnë me insistim me vu kurorë në xhami dhe pastaj nëpër rrjete sociale me gotat e shampanjës dhe komentet poshtë: “Allahu ju begatoftë, Allahu ju shtoftë e Allahu... Allahu...”!

Kur nuk ke turp vepro ç'të duash!

Se çfarë ka lidhje harami me festimet e hutuara e gëzimet tona, duhet t'i pyesim ata, të cilët kanë hequr perden e turpit. Fetarizmi është diku dhe shthurja dhe e reja e modernia është diku tjetër.

Disa të rinj, që i shoh me pantallona të shkurtra, dhe këtë e kam thënë disa herë, pra me auret përjashta, dhe kur

vjen në xhami, me vrap për të marrë një “bohçe” për të falë namazin!? Ajo veshje, me të cilën ke turp për t'i dalë përpara Zotit, është e ndaluar për të dalë si njeri me dinjitet edhe jashtë në rrugë, o i dashur dhe i shtrenjtë.

Kur nuk ke turp vepro ç'të duash!

Këtu, Bismillah, Mashallah, La ilahe il-lallah dhe vlon rrjeti me komente dhe devotshmëri. Ndërsa në përditshmëri në marrëdhëniet në tregti, në shitblerje, në marrëdhëniet sociale, në marrjen e borxhit, në mos kthimin e borxhit, me hilet, etj, etj., me nijet...!?

Këtu “Mashallah, Mazallah, këtu Eudhu bil-lah!”Pse? Sepse; Kur nuk ke turp vepro ç'të duash!

Allahu na udhëzoftë dhe na bëftë nga ata që e dëgjojnë fjalën dhe veprojnë më të mirën e saj!

Amin!

(Hytbeja e xhumasë e mbajtur në xhaminë e Parrucës, më 19 gusht 2022)


Diktoi:

Siditë Hafzi

“MEGJITHËSE TEK NE ËSHTË LIKUIDUAR BAZA SOCIALE EKONOMIKE E FESË, NDIKIMI I SAJ NDIHET SIDOMOS NË FSHAT...”, SHKRUHET KËTU E PAK DEKADA MË PËRPARA. SHIKONI E NJËJTA PAMJE KA DISA EMRA TË PËRVEÇËM QË SHKRUHEN SOT, KEMI DISA EMRA TË TJERË TË PËRVEÇËM QË SHKRUAJNË. KJO LËVIZJE QË PO FILLON NGA POSHTË TË PËRHAPET TREGON SE VETË MASA TË MARRIN PJESË AKTIVE NË FORMIMIN E NDËRGJEGJES SË TYRE SOCIALISTE.



QYTETI I HUMBUR I XHAMIVE... SI I FSHEHËN GREKËT MONUMENTET OSMANE SELANIKASE?



Megjithëse Selaniku mbeti nën ombrellën e sundimit osman për më shumë se 5 shekuj me radhë dhe njëhej si "Qyteti i Minareve" për shkak të numrit të madh të xhamive, grekët arritën gjatë shekullit të kaluar të fshehin xhamitë e Selanikut dhe "qëllimisht dhe sistematikisht" shkatërruan minaret dhe monumentet e tyre, me qëllim që t'i zhveshin nga historia e tyre osmane.

Një foto arkivore e qytetit të Selanikut, i cili mbeti osman për më shumë se 5 shekuj dhe u njoh si "Qyteti i Minareve" për shkak të numrit të madh të xhamive.

Uzarpimi i të drejtave të turqve të krahinës së Trakës Perëndimore dhe refuzimi i autoriteteve greke për të zbatuar vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, nuk është gjë tjetër, veçse një vazhdimësi e serisë së grabitjeve të të drejtave të muslimanëve dhe persekutimit të tyre, që nga viti shpërthimit të rebelimeve të ndezura nga grekët kundër Perandorisë Osmane, në fillim të shekullit të 19-të.

Po të marrim si shembull Selanikun (Selanikun), vëmë re se qyteti bregdetar, që mbeti osman për më shumë se 500

vjet dhe që njëhej si "Qyteti i Minareve", tashmë është plotësisht bosh nga xhamitë dhe sot asnjë xhami nuk është e hapur për adhurim.

Për 500 vjet, Selaniku ishte një qytet turk i dallueshëm, që mbizotëronte bashkëjetesa dhe tolerancë lagjeve dhe rrugicave të tij; ku turqit, grekët dhe hebrenjtë jetonin në paqe të plotë nën sundimin osman. Tregtia u zhvillua falë hekurudhave dhe porteve të ndërtuara nga osmanët dhe në sajë të së cilës qyteti u bë një bazë ekonomike dhe një qendër tregtare për të gjithë rajonin e Ballkanit, deri në atë masë sa u cilësua atëkohë si "porta e Evropës", pas traktateve të lidhura nga Perandoria Osmane me Austro-Hungarinë dhe Rusinë, duke u formuar në qytet një shtresë madhe tregtare, që kishin marrëdhënie me të gjitha vendet evropiane.

SELANIKU OSMAN

Ashtu si shumica e tokave greke që ranë nën sundimin osman, disa dekada përpara se osmanët të pushtonin qytetin e Stambollit në 1453, osmanët aneksuan qytetin e Selanikut nën ombrellën e sundimit të tyre, përfundimisht gjatë mbretërimit të Sulltan Muradit II në vitin 1430.

Gjatë periudhës osmane, qyteti dëshmoi një rritje të numrit të muslimanëve dhe hebrenjve, ndërsa

numri i hebrenjve u rrit në mënyrë të vazhdueshme, për shkak të persekutimit të hebrenjve të Spanjës gjatë inkuizicionit.

Me kalimin e kohës, qyteti kishte në përbërje tre grupe kryesore etnike: Myslimanët turq, grekët ortodoksë dhe hebrenjtë sefardikë (të ardhur nga Spanja)... derisa ndryshoi gjithçka me marrjen e qytetit nga rebelët gjatë Luftës së Parë Ballkanike, më 9 nëntor 1912.

ZHVESHJA E QYTETIT NGA KUJTESA E TIJ

Marrja e qytetit nga rebelët, jo vetëm që ndryshoi përbërjen e tij demografike dhe etnike, por gjithashtu ky ndryshim u zgjerua edhe më tej, duke përfshirë kujtesën e tij dhe duke shkatërruar historinë dhe arkitekturën e tij të shkëlqyer, që filloi të shkatërrohej, që nga viti 1912. Ashtu siç u morën pronat e muslimanëve dhe të hebrenjve, lagjet dhe rrugicat, ashtu edhe shumë xhami në Selanik u shndërruan në kisha, Aja Sofija, El-Kasimije, Xhamia e Vjetër, Wartashi Sulltan, Ismail Pasha, Eki Shirveli, shtu këtu dhe xhamitë e Sulltan Muradit, që janë pjesë e këtyre xhamive.

Pas kësaj, qyteti historik turk iu la zyrtarisht Greqisë me Traktatin e Athinës të vitit 1913. Në atë kohë, në qytet jetonin 61.430 hebrenj, 45.867 turq dhe 39.956 grekë.

Në Luftën e Parë Botërore, forcat aleate hynë në Selanik dhe prej aty u hap fronti maqedonas kundër bullgarëve. Kur më 18 gusht 1917, qyteti u pushtua, shpërtheu një zjarr, që jo vetëm shkatërroi ndërtesat dhe xhamitë e qytetit, por gjithashtu detyroi të shpërngulen rreth 70.000 banorë. Ky zjarr shkaktoi emigrimin (largimin) e shumë banorëve të tij myslimanë dhe hebrenj në Turqi dhe u zëvendësuan me emigrantët grekë të sjellë nga Azia e Vogël, përmes procesit të shkëmbimit të popullsisë në vitin 1923.

"QYTETI I MINAREVE"

Gjatë gjithë epokës osmane, e cila zgjati më shumë se 5 shekuj, minaret zbukuruan qytetin bregdetar të Selanikut, derisa ai u njoh si "Qyteti i Minareve". Me kalimin e kohës, qoftë si pasojë e tërmeteve dhe zjarreve, por qoftë edhe sipas metodës së shkatërrimit artificial (nga dora e njeriut), në qytet nuk mbeti, veçse një minare në mesin e 139 xhamive të mëdha, që ishin në Selanik në vitin 1923.

Selaniku njihet si qyteti i dytë më i madh në Greqi pas Athinës, dhe pamja e tij ngjason shumë me qytetin turk të Izmirit në Anadollin perëndimor. Megjithatë, 98% e ndërtesave dhe punimeve me arkitekturë turke u shkatërruan. Ndërtesat që i rezistuan djegies dhe shkatërrimit sistematik nuk e përballuan dot tërmetin e viteve 1936 dhe 1978 dhe në vend që të rindërtoheshin e të restauroheshin, u fshinë tërësisht nga historia!

Shumë xhami historike në Greqi u përdorur për shumë vite në kundërshtim me qëllimin e ndërtimit të tyre. Ndërkohë, disa xhami u shndërruan në kisha, muze dhe sallone (salla ekspozitash), disa të tjera u kthyen në bare apo kinema, e ndërsa shumë xhami të tjera u lanë në mëshirën e fatit (deri në shkatërrim dhe degradim).

Shkatërrimi i grekëve nuk u kufizua vetëm në ndërtesa dhe xhami, pasi ato gjithashtu u shtrinë edhe në varret e muslimanëve. Tregohet se, në mesin e varreve që u shkatërruan, ishte edhe varri i Ali Riza Efendiut, babait të themeluesit të Republikës së Turqisë, Mustafa Kemal Atatürkut.

(www.trtarabi.com)

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Lavdim Hamja

PAPA PIU II SHKRUAN PËR SULLTAN MEHMETIN II



Fragmenti i mëposhtëm vjen nga letra - me gjasë e padërguar - që papa Piu II shkruan për sulltan Mehmetin II. Hendeku mes papës dhe sulltanit, në fund të fundit, mbushej me "pak ujë". Me të zhdukej çdo diferencë, pastrohej gjaku, pushtimi bëhej çlirim, Lindja zbulohet Përendim, hordhitë pranoheshin në vëllazëri.

"Dhe sigurisht ti nuk vlen më pak se Justiniani. [...] Jemi të vetëdijshëm se paraardhësit e tu të lavdishëm kanë bërë gjëra të mëdha, jo se vepra jote është më e vogël: ke fituar mbi Kostandinopojën, kolonia xhenoveze e Peras në rrethinat e Bizantit dhe pjesa më e madhe e Peloponezit u janë dorëzuar ushtrive të tua; në Serbi dhe në Vllahi nuk ke fituar pak toka [...]. Të duken gjëra të mëdha, e ne nuk themi se janë të vogla.

[...] Nëse do ta shtrish autoritetin tënd mbi të krishterët dhe ta shndërrosh emrin në më të lavdishmin e mundshëm, nuk ke nevojë për flori, armë, ushtri, flota. Diçka e thjeshtë mund të të transformojë në më të madhin, më të fuqishmin dhe më të famshmin njeri të kohës sonë [...]: pak ujë që të pagëzohesh dhe të adoptosh ritet e krishtera e të besosh në Ungjill. Po e bërë, nuk do të ketë princ në tokë që

të mund të ta kalojë për nga lavdia dhe të të afrohet për nga pushteti. Do të të quajmë perandor i Greqisë dhe Orientit, e ajo çfarë tani zotëron me dhunë dhe joligjërisht do ta kesh me të gjitha të drejtat. Të gjithë të krishterët do të të jenë të devotshëm dhe do të të zgjedhin si gjykatës [...].

Selia e Shenjtë do të ketë ndaj teje të njëjtën dashuri që ushqen për mbretërit e tjerë, madje aq e madhe sa do të jetë pushteti yt mbi të tyrin.

[...] Sa janë ata [ballkanas] që refuzojnë t'i nënshtrohen autoritetit tënd vetëm e vetëm se nuk je i krishterë? [...] Por sikur të ishe i pagëzuar dhe bashkë me ne të rrugëtoje në shtëpinë e Zotit sipas ortodoksisë [Kishës katolike], ata nuk do të kishin aq frikë nga sundimi yt dhe ne nuk do t'i ndihmonim kundër teje, por madje do të kërkonim të ndërhyje kundër tyre, sepse nganjëherë uzurpojnë prerogativat e Kishës së Romës."

Luca D'Ascia, "Il Corano e la tiara. L'epistola a Maometto II di Enea Silvio Piccolomini (papa Pio II)", Bologna 2001, f. 234-237.

(marrë nga fb: Post Blllok)



Besim Barbullushi
Imam - Xhamia Rus

Hapi i parë që duhet bërë që prindërit t'u japin fëmijëve edukimin e duhur është të reformojnë gjykimet e tyre morale dhe vlere. Sepse dihet që një fëmijë i porsalindur imiton qëndrimet dhe sjelljet e prindërve deri sa të arrijë moshën e rritjes dhe i adopton ato. Prandaj, të gjithë anëtarët e familjes, veçanërisht prindërit, duhet të përpiqen të japin një shembull të mirë për fëmijën. Profeti (a.s) ka thënë: “Çdo fëmijë lind i pastër dhe pa gjynahe (një cilësi që mund të pranojë fenë e vërtetë). Janë prindërit që me edukimin e tyre atë e bëjnë hebre, të krishterë ose mexhusi”.¹

Ky hadith deklaron qartë shkallën e ndikimit të mjedisit të afërt në karakterin dhe personalitetin e fëmijës. Hz. Muhammedi (a.s) e përkuftizon edukimin e fëmijëve si një e drejtë e prindërve.² Kështu që Profeti (a.s) i lavdëron prindërit, të cilët zbatojnë edukimin dhe disiplinën e duhur, që është një nga nevojat shpirtërore të fëmijëve të tyre, me fjalët: “Babai nuk i ka dhënë fëmijës dhuratë më të vlefshme se edukimi i mirë”.³

Dhembshuria dhe mëshira janë në krye të parimeve të Profetit Muhammed (a.s) në lidhje me rritjen dhe edukimin e fëmijëve. Profeti ynë (a.s), i cili kishte një dashuri të thellë për fëmijët, para së gjithash i merrte fëmijët seriozisht dhe përpiquej t'i zgjidhte problemet e tyre duke i parë në sy, duke folur me ta dhe duke i dëgjuar. Fakti që Profeti (a.s) u kujdes për ta, i përshëndeti dhe iu drejtua duke pyetur për gjendjen e tyre, përveç ndjeshmërisë dhe dhembshurisë ndaj fëmijëve, ndaj të cilëve Profeti (a.s) kujdesej për vendin e tyre në

1. Buhari, Cenaiz, 80; Muslim, Kader, 22-25.
2. Ibn Mace, Edeb, 3.
3. Buhari, Birr, 33.

MARRËDHËNIET E PROFETIT (A.S) ME FËMIJËT

familje dhe prandaj në shoqëri i bënte të ndiheshin të vlefshëm.⁴

Ai gjithashtu ka respektuar të drejtat e fëmijëve duke kundërshtuar disa nga zakonet dhe traditat e gabuara të arabëve ndaj fëmijëve. Duke e treguar hapur dashurinë e tij, ai u përpoq të përmbushte dëshirat e tyre të arsyeshme. Profeti ynë (a.s) u afrohej fëmijëve me një dhembshuri të tillë, sa që ai kurrë nuk hoqi dorë nga ky qëndrim edhe gjatë lutjes.

Ai e zgjati sexhden për mbesën e tij në shpinë, i mbante në krahë gjatë hytbes dhe e mbante Hasanin dhe Huseinin mbi supe gjatë namazit, si dhe mbesën e tij, Umamen, pa bërë dallim mes djemve dhe vajzave.⁵ Ai ka dashur të shprehet se ato janë pjesë e rëndësishme e jetës dhe e ardhmes së shoqërisë muslimane duke urdhëruar që fëmijët dhe gratë të marrin pjesë në namazin e Bajramit, që është një nga adhurimet dhe takimet më të rëndësishme të shoqërisë islame.⁶

“Mjedisi familjar”, në të cilin fëmija dallon të drejtën nga e gabuara, jeton dhe rritet, është një nga elementët më vendimtarë të edukimit. Tregohet për një ngjarje ku Profeti (a.s) po qëndronte në shtëpinë e një nga sahabiu Abdullah ibn Amrit. Bashkëshortja e sahabiut e thirri djalin e saj dhe i tha se do t'i jepte diçka. Profeti e pyeti gruan, se çfarë do t'i jepte. Kur zonja tha se do t'i jepte hurma të freskëta fëmijës së saj, Profeti (a.s) tha: “Po ta kishit gënjyer dhe të mos kishit dhënë diçka, do t'iu ishte shkruar një mëkat”.⁷

Kështu, Profeti theksoi rëndësinë e vendosjes së një komunikimi të bazuar në besnikërinë dhe besimin midis prindërve dhe fëmijëve të tyre duke deklaruar se nëna nuk duhet ta mashtrojë fëmijën e saj edhe me qëllime të mira dhe se nëse e bën, ajo do të bjerë në gënjeshtëri, që është një nga mëkatet e mëdha në sytë e Islamit. Bazuar në këta shembuj, prindi; Kuptohet që me qëndrimet dhe sjelljet e tyre fëmijëve duhet t'u jepet përvoja e të jetuarit në një mjedis “miqësor dhe

4. Buhari, Edeb 81; Muslim, Selam, 15.
5. Buhari, Fedailu's-Sahabe 22, İlim 18; Tirmidhi, Menakib 9, Birr 57; Ebu Davud, Terexh-xhul 15; İbn Maxhe, Edeb, 3
6. Buhari, İydejn, 15-16.
7. Ahmed b. Hanbel, Musned, III, 447.

të besueshëm”.⁸

Një çështje tjetër për sa i përket fëmijëve dhe i Dërguari i Allahut i kushtoi rëndësi është edhe identiteti i fëmijëve, që fillon edhe nga vendosja e emrit. Profeti Muhammed (a.s) i informoi muslimanët se është e nevojshme të tregohen shumë të kujdesshëm dhe të përpiktë në emërtimin e fëmijëve dhe dha këshillën e mëposhtme: “Do të thirreni me emrat tuaj dhe me emrat e baballarëve tuaj në Ditën e Gjykimit, jepini fëmijëve tuaj emra të mirë”.⁹

Ai rekomandoi se emrat që ngjallin paganizëm në kohën e injorancës dhe që nuk janë të përshtatshëm për fenë tonë, të ndërrohen pasi të bëhen

8. Adem Apak, “Hz. Peygamber'in (sav) Çocuklarla İlişkileri Üzerine Tespit ve Değerlendirmeler”, UÜİF Dergisi, no. 19, 2010, f. 46.
9. Ebu Davud, Edeb, 69.

“DO TË THIRRENI ME EMRAT TUJ DHE ME EMRAT E BABALLARËVE TUJ NË DITËN E GJYKIMIT, JEPINI FËMIJËVE TUJ EMRA TË MIRË!”

myslimanë. Ai ka ndryshuar edhe emra që nuk përputhen me etiketën islame. Ai i pranoi si haram emrat si “Abdu'l-Uzza” dhe “Abdu Menaf”, që do të thotë robëri tjetër përveç Allahut, dhe i ndryshoi emrat e fëmijëve me këta emra në emra të tjerë.¹⁰ Gjatë udhëtimit, ai mori nipërit e tij në devenë e tij dhe u përpoq të komunikonte me ta duke bërë shaka dhe duke u kujdesur për ta.¹¹ Kështu, ai fitoi miqësinë dhe besimin e tyre dhe arriti të hyjë në botën e tyre.

Këtë dhembshuri të Pejgamberit tonë (a.s) e shohim me sjelljen që kishte me Enes ibn Malik, të cilin në një moshë fëmijërore nëna e dërgoi tek Profeti Muhammed. Enesi (r.a) e tregon ngjarjen që tregon qëndrimin e të Dërguarit të Allahut (a.s) ndaj tij si vijon: “Një ditë i Dërguari i Allahut (a.s) më dërgoi për një porosi. Megjithatë

10. Buhari, Edeb, 108.
11. Buhari, İlim, 18; Tirmidhi, Birr, 57; Ebu Davud, Edeb, 92.

unë rrugës u bashkova me fëmijët që luanin në rrugë. Pas një kohe të caktuar, i Dërguari i Allahut (a.s) erdhi në vendin ku ishim ne dhe më pyeti nëse kisha shkuar në vendin ku më dërgoi. Unë iu përgjigja: “Po largohem menjëherë o i Dërguar i Allahut”.¹²

Në këtë situatë edhe pse kishte harruar ta çonte në vend përgjegjësini, që i kishte dhënë Profeti (a.s), ai nuk e qortoi duke marrë parasysh edhe moshën që kishte.¹³ Domethënë, Profeti i dha fëmijës aq përgjegjësi sa mundi dhe ndoqi detyrën që i kishte dhënë pa e qortuar. Në vend që të përdorte gjuhë kritike ndaj fëmijëve, ai shfaqti një qëndrim inkurajues. Edhe kur e pa se detyra ndaj Enesit (r.a) nuk iu plotësua, në vend që të zemërohej dhe ta poshtëronte, iu afrua me dhembshuri dhe ia kujtoi përgjegjësinë. Kjo metodë zgjon një ndjenjë përgjegjësie të brendshme që buron nga dashuria, në vend që të bëjë atë që duhet bërë sepse fëmija ka frikë nga autoriteti.


Profeti (a.s), i cili ishte gjithashtu shumë i shqetësuar për shëndetin dhe sigurinë e fëmijëve, preferonte të lexonte sure të shkurtra kur dëgjonte zhurmën e të qarit, duke u shqetësuar për situatën dhe duke menduar për nënën e tij, edhe pse kishte ndërmend të lexonte sure të gjata duke u falur me xhemat.¹⁴ Hz. Muhammedi (a.s) e shpjegon këtë situatë si vijon: “Unë qëndroj në namaz me qëllimin që të zgjas leximin tim. Por kur dëgjoj një fëmijë duke qarë nga pas, e shkurtoj namazin që të mos i shkaktoj telashe nënës së tij”.¹⁵

Me të dëgjuar lajmin për sëmundjen e një fëmije, Profeti ynë (a.s) u mërziiste shumë për këtë situatë, e vizitonte fëmijën dhe e ndiqte nga afër gjendjen shëndetësore.¹⁶ Ai ndalonte rreptësisht dëmtimin e të moshuarve, grave dhe fëmijëve, edhe në situata të jashtëzakonshme si lufta.¹⁷ Duke e kontrolluar vetë ushtrinë, ai refuzoi ata që ishin nën moshë dhe donin të luftonin në ushtrinë islame për sigurinë e tyre. Një nga aspektet më të rëndësishme të

12. Muslim, Fedail, 51, 54.
13. Buhari, Vesaja, 25.
14. Buhari, Edeb, 18; Muslim, Mesaxhid, 42.
15. Buhari, Ezan, 65; Muslim, Salât, 186, 192.
16. Buhari, Merda, 9.
17. Buhari, Xhihad ve's-Sijer, 147-148.

mesazhit të Islamit është mbrojtja e të drejtave të grupeve më të dobëta dhe më të cënueshme në shoqëri, siç janë fëmijët, gratë, skllëvërit, jetimët dhe të varfrit.

Ndërkohë që dhuna ndaj vajzave në periudhën e injorancës shkonte në shkallën e vrasjes, Kur'ani e dënoi dhe e ndaloi këtë shëmti.¹⁸ Hz. Muhammedi (a.s) luftoi shumë për të korrigjuar këto zakone dhe tradita të gabuara dhe si baba i një vajze, ai dha shembull për shoqërinë. Në të njëjtën kohë, ata që rritën dhe edukuan vajza; i bashkoi gishtat duke thënë: “Kushdo që kujdeset, i rritë dhe i edukon dy vajza, derisa të arrijnë moshën e pubertetit dhe ta përmbushin këtë, do të jetë



kështu me mua, në ditën e gjykimit”.¹⁹ Nga ana tjetër, ai dënoi ata që kanë mendime të këqija për vajzat e tyre dhe i shohin këta fëmijë si të meta.²⁰

Siç e ndalon Islami padrejtësinë ndaj vajzave, po ashtu i ndalon prindërit që të bëjnë padrejtësi mes fëmijëve të tyre. Prandaj, çdo fëmijë duhet të përfitojë në mënyrë të barabartë nga vlerat dhe mundësitë e familjes. I Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë se prindërit duhet t'i trajtojnë fëmijët e tyre në mënyrë të barabartë si e drejta më e natyrshme e fëmijëve.²¹ Në lidhje me këtë, ai tha: “Një nga të drejtat e fëmijëve ndaj jush

18. Kuran, En-Nahl, 16/58-59.
19. Muslim, Birr, 149.
20. Hejsemi, Mexhmau'z-Zevaid, VIII, 156.
21. Buhari, Hibe, 12-13; Muslim, Hibat, 9-19.

është trajtimi i barabartë me ta”.²² Për shembull; Në periudhën e injorancës ka pasur padrejtësi ndaj grave dhe vajzave në trashëgimi, si në shumë çështje të tjera.

Nga ana tjetër, Islami ka qenë i përpiktë në dhënien e të drejtës së trashëgimisë vajzave ashtu si djemtë. Trashëgimia, dhuratat, veshjet, etj. Ashtu si në çështjet materiale, prindërit duhet të respektojnë barazinë edhe në çështjet shpirtërore. Përndryshe, kjo situatë mund të shkaktojë që fëmijët të zgjohen ndjenja të tilla si urrejtja dhe zilia dhe të shkaktojë ndjenja negative midis vëllezërve dhe motrave.²³

Përsëri, në lidhje me këtë, Profeti ynë (a.s) ka një urdhër të prerë: “Kini frikë Allahun dhe respektoni drejtësinë mes fëmijëve tuaj”.²⁴ Sigurimi i drejtësisë mes fëmijëve dhe shmangia e çdo lloj pabarazie është një nga elementët më të rëndësishëm për unitetin dhe qetësinë e familjes dhe kuptohet se e kundërta mund të shkaktojë zemërimin e Allahut dhe shfaqjen e problemeve të pariparueshme brenda familjes.²⁵

Hz. Muhammedi (a.s.) ishte i interesuar për të ardhmen e fëmijëve po aq sa interesohej për arsimimin dhe edukimin moral të fëmijëve dhe dëshironte, që ata të ishin të fortë ekonomikisht. Mori masa që të mos kishin nevojë për askënd dhe kështu në mënyrë të vazhdueshme paralajmëroi prindërit.

Sipas transmetimeve, një ditë Sa'd ibn Malik (r.a) erdhi tek Hz. Muhammedi (a.s) dhe tha se donte të shpenzonte të gjithë pasurinë e tij në rrugën e Allahut. Më pas, Profeti (a.s) e pyeti: “Çfarë ke lënë për fëmijët e tu?”. Kur sahabiu u përgjigj: “Unë nuk u kam lënë asgjë”, Profeti nuk e mirëpriti këtë përgjigje dhe i tha atij se ai duhet t'ua linte 9/10 e pasurisë së tij fëmijëve të tij. Kur sahabiu këmbënguli, ai kërkoi që t'i lërë trashëgim 1/3 e pasurisë së tij dhe deklaroi se edhe kjo shumë ishte e vogël.²⁶

22. İbn Maxhe, Tixharet, 67.
23. Adem Apak, “Hz. Peygamber'in (sav) Çocuklarla İlişkileri Üzerine Tespit ve Değerlendirmeler”, UÜİF Dergisi, no. 19, 2010, f. 52.
24. Buhari, Hibe, 12.
25. İbrahim Sarıçam, Hz. Muhammed ve Evrensel Mesajı, (Ankara: DİB Yayınları, 2. B, 2004), f. 301-304.
26. Tirmidhi, xhenaiz, 6.

Prandaj, përgjegjësitë e prindërve ndaj fëmijës nuk kufizohen vetëm në edukimin e tij, por përfshijnë edhe kujdesin, trajtimin dhe të gjitha llojet e nevojave të tij. Nëse prindërit nuk i plotësojnë këto nevoja, shteti duhet të kujdeset për fëmijët. Në fakt, Hz. Profeti (a.s) nuk la asnjë fëmijë në shoqëri të

PRINDËRIT DUHET T’I RRSIN FËMIJËT ME MORAL TË MIRË DHE TË BËJNË PËRPPJEKJE E SAKRIFICA PËR T’I UDHËHEQUR ATA DREJT NJË PROFESIONI TË MIRË. PRINDËRIT QË I KUPTOJNË DHE I PËRMBUSHIN KËTO PËRQJEGJËSI, MBI TË QJITHA VLERAT MATERIALE PËR FËMIJËT E TYRE, SIPAS FJALËVE TË PROFETIT (A.S), “ATA LËNË TRASHËGIMINË MË TË MIRË”

pambrojtur dhe pa mbikëqyrje duke thënë: “Unë jam kujdestar i atij që nuk ka kujdestar”.²⁷

Një ngjarje e ndodhur në fillim të vitit të 9-të hixhri tregon shumë mirë se Profeti ynë (a.s) kujdesej për të drejtat materiale të fëmijëve dhe u jepte rëndësi atyre. Sipas ngjarjes, një delegacion prej shtatëdhjetë a tetëdhjetë personash erdhën nga Beni Temimi në Medine për të vizituar të Dërguarin e Allahut (a.s). Në këtë delegacion bënte pjesë edhe një djalosh që quhej Amr ibn Ehtem. Ky djalosh ishte caktuar nga anëtarët e delegacionit të qëndrojnë pranë deveve si mbikëqyrës.

Kur Profeti (a.s), i cili përgatiti dhe shpërndau dhuratat të veçanta për ata që vinin, pyeti nëse ka ndonjë që nuk kishte marrë dhuratë, ata thanë se vetëm fëmija që ruante mallin nuk kishte marrë gjë. Kur Profeti urdhëroi që fëmijës t’i jepej një dhuratë, një nga anëtarët e delegacionit, Kejs ibn Asim shpjegoi se ai fëmija nuk kishte ndonjë pozitë të rëndësishme midis fiseve të tyre. Më pas, Hz. Profeti (a.s) tha: “Epo, ai erdhi me delegacionin. Ai ka të drejtë të marrë bakshish.” Më pas solli me vete fëmijën dhe i dha dhuratën.²⁸

27. Tirmidhi, xhihad, 21.

28. Mustafa Öcal, “Hz. Peygamber’in Çocuk Eğitimindeki Metodu”, Hz. Muhammed ve Gen-

Në këtë drejtim, Islami, i cili mbron të drejtat e fëmijëve ndaj shoqërisë injorante, e cila është e goditur nga padrejtësia, thekson edhe respektimin e të drejtave të fëmijëve jetimë. Në ajet, Zoti ynë urdhëron në lidhje me të drejtat dhe ligjet e fëmijëve jetimë:

“... Mos gllabëroni pasurinë e tyre duke harxhuar dhe me nxitim, se ata do të rriten (dhe do t’ua marrin pasurinë). Kush është i pasur (nga prindërit) të mos nënshtrohet (të hajë nga pasuria e një jetimi). E kush është i varfër, le të hajë (aq për shërbimin e tij) në përputhje me kërkesat e arsyes dhe fesë. Kini dëshmitarë me ta kur t’ua ktheni pasurinë e tyre. Mjafton Allahu si llogaritës. Nëse janë të pranishëm të afërmit, jetimët dhe të varfrit (që nuk kanë pjesë në trashëgimi), ata që shqetësohen për ta duhet të dridhen dhe të kenë frikë (edhe për jetimët). Le ta kenë frikë Allahun dhe le të thonë të vërtetën. Ata që hanë pasurinë e jetimëve pa të drejtë, do të hanë vetëm zjarr për të mbushur barkun e tyre dhe do të hyjnë në një zjarr flakëruar (ferr)”.²⁹

I Dërguari i Allahut (a.s.) në një hadith për jetimët ka thënë: “Nëse një person merr një jetim në mesin e muslimanëve dhe e çon në shtëpinë e tij për të ushqyer e për të pirë, Allahu patjetër do ta vendosë atë në xhenet, përveç nëse ai kryen një krim të pafalshëm”.³⁰

Fëmija nuk është vetëm një çështje argëtimi dhe kënaqësie për prindërit e tij. Është e nevojshme ta mbështesim në të gjitha aspektet dhe ta edukojmë e aftësojmë në përputhje me kushtet e kohës. Prindërit duhet t’i rrisin fëmijët me moral të mirë dhe të bëjnë përpjekje e sakrifica për t’i udhëhequr ata drejt një profesioni të mirë. Prindërit që i kuptojnë dhe i përmbushin këto përgjegjësi, mbi të gjitha vlerat materiale për fëmijët e tyre, sipas fjalëve të Profetit (a.s), “ata lënë trashëgiminë më të mirë”.³¹


Përgatitja e fëmijëve për jetën shoqërore në kuptimin material dhe shpirtëror dhe të menduarit për të ardhmen e tyre të kësaj bote dhe të botës tjetër konsiderohet si një nga detyrat kryesore të një prindi të arsyeshëm.

çlik, Ankara 1995, s. 73-79.

29. Kurani, En-Nisa, 4/6-10.

30. Tirmizi, Birr, 14.

31. Tirmizi, Birr, 33.




Pejgamberi (a.s) ka thënë:

“*Besimtari
arrin me
mirësjelljen e tij,
gradën e atij
që falet
dhe atij
që agjëron!*”



(Transmetuar nga Ebu Davudi dhe Ibn Hibbani)



Xhahid Bushati, shkrimtar

“**M**editime” është libri më i ri i autorit Muhamed Bardhyl Sytari. Kur flasim për një libër të ri të këtij autori prodhimtar, e ndiejmë të domosdoshme të flasim edhe rrugëtimin e librave të mëparshëm që mbajnë firmën e tij e, që formojnë personalitetin e teologut Sytari dhe njëkohësisht kontributin e tij të vyer, që përfshin e spektrohet në disa hapësira, si: - në përkthime, - në libra me natyrë teologjike, - në libra me kujtime e refleksione, - në monografi, - në libra që përmes kulturës së autorit përçojnë tek lexuesi e më gjerë Udhëzimet Kur’anore, etj.

“Meditime” është një pikëarritje e re në krijimtarinë e autorit, një dritare e bukur plot ngjyra, ku njeriu vështron kohën, realitetin, ballafaqohet me to, ballafaqohet me vetveten, me kujtimet, me gjurmët që lë në jetë, beson te vetvetja, beson te vlerat e virtytet, beson te mirësia, humanizmi, bamirësia..., ashtu siç thotë autori, më parë nga të gjitha, te: “Dashnia e Allahut në zemrën e njeriut”.

Libri përmban 77 meditime, ku i paraprin si një univers hyjnor e jetësor, e si kredo ku zbërthehen shenjat e librit dhe thelbri i përmbajtjes së tij, i titulluar: “Meditim në hyrje”.

Si në librat e mëparshëm edhe në këtë libër, rrezatojnë disa dukuri, si: kultura e gjerë e autorit, qasja ndaj fenomenit apo ngjarjes së ndodhur, akti qytetar që nënvizohet, vlerat e virtyteve që duhet t’i përqafojmë, modeli i së mirës që duhet përhapur... etj.


Në vijim të shtjellimit të temave që kanë hallka ndërlidhëse mes njëra tjetrës, dua të përmend edhe disa dukuri të tjera që shfaqen në këtë libër, si: e

MEDITIME...

-PËRSIATJE PËR LIBRIN “MEDITIME”

TË AUTORIT MUHAMED B. SYTARI, BOTIMET “LOGOS-A, SHKUP, 2022-

parëndësishmja si bëhet e rëndësishme, e thjeshta shkon gjer në madhësi, e zakonshmja pa u vënë re bëhet vlerë shoqërore, veprimi i thjeshtë, shpesh i panjohur bëhet sjellje e kulturuar në shërbim të njerëzve dhe të jetës së qytetit, e panjohura bëhet e njohur. Në këtë libër qytetaria mbart dimensionet të humanizmit, bamirësisë, të solidaritetit, të respektit për njëri-tjetrin. Në këtë libër fjala e thënë plot mirësi ndriçon veprimin dhe personazhin, edhe pse ai mbetet i zakonshëm e pa dekorata, edhe pse shumëkush nuk e njeh. Por Ai njeh Dashurinë ndaj Allahut dhe në ndërgjegjen e tij ka filozofinë e Mirësisë.



Brenda strukturës së librit, MEDITIME-T ndahen në disa tipologji, të cilat lidhen me trajtesat e problemeve, historive e ndodhive. Gjithashtu, ata lidhen me këndvështrimet, me shtjellimet vetjake, me personazhet që “lëvizin” në aktet e me aktet e veprimeve që bëjnë, me mesazhet që përcillen e bashkohen, përsëri siç thotë autori: “Feja mbi të gjitha!”

Për arsye të përcjelljes së vlerave të librit, po mundohem të trajtoj një problematikë që zë vendin më të rëndësishëm e rrezaton në libër. Ajo është: DASHNIA E ALLAHUT...

Po përmend disa tituj shkrimesh, që lidhen me këtë problematikë, si:

-“Dashnia e Allahut në zemrën e njeriut, - Feja mbi të gjitha!, - Kjo është rruga ime!, - Sa shumë e dëmtojnë fenë disa praktikantë të saj!?, - Ibrahimzi nuk është fe!, - Ramazani, muaji i xhenetit!, - Të gjithë nevojtarë për faljen e Zotit të tanësisë!, - Unë jam afër..., - Ramazani si frymë e dinamikës në jetë, - Nata e pozitës së lartë..., - Çfarë ke bërë sot për Zotin tënd?, - Nevoja për një edukator në besim e fe!, - Nëse nuk bëhemi rregullatorë, nuk do të na vlejë të jemi prej të mirëve!, - Kënaqu me kaderin tënd..!, - Koha për ta nxjerrë Islamin nga xhamia..., - Jusufi këtë e mbajti fshehtë në veten e tij... (Kur’ani, Jusuf: 77), -Dorëzohu me sy mbyllur në krahët e kaderit..!, - Islami folklorik, nuk është feja ime!, - E xhumaja si simbol i rimëkëmbjes!, - Hidhe tutje hirkën e hutimit..!, - Në daçin t’a pranojnë njerzët në daçin jo, aj Besim mbetet gjithnji i saktë!”

Po cilësoj disa fjalë kyçe:

-Allah, zemër, njeri; rrugë; Ramazan, muaj, xhenet; falje, afër, frymë, edukator, besim, fe; kader, xhami, e xhuma, etj. .

Këto fjalë kyçe, si shumë të tjera që gjenden në tekstin e librit, janë vatra të dritshme. Autori që në konceptin e tij, në mënyrën e shtjellimit të tekstit, në kohën që vendos ngjarjen në ballafqim me realitetin ekzistues, apo fabulën që ndërton e udhëzimin përkatës që jep, trajtesën poetike, skalitjen e personazhit dhe vizionin që fal krijon një pemë gjenealogjike jetësore, ku MEDITIME-T flasin dhe frymojnë shqip.

Portreti i librit, fraza e mbrujtur me leksikun e shqipes së bukur, artikulimi i qartë i frazës, na bëjnë të themi se pozicioni i teologut është i gërshetuar me pozicionin e krijuesit të talentuar letrar. Kjo është arsyeja që fraza e përdorur mbart ngjyra, emocione dhe akte besimi. Zakonisht tipologjitë e të tillë librave nuk shfaqen shpesh në botimet tona. Libri MEDITIME-t e plotëson sadopak këtë boshllëk. Në këtë libër spikat kultura e autorit Muhamet B. Sytari, qartësia e trajtimit të problemit, modeli poetik i të shkruarit.

TAXHIKISTANI

Taxhikistani, ose zyrtarisht Republika e Taxhikistanit, është një vend në Azinë Qendrore, pa dalje në det. Ai kufizohet me Kirgistanin në veri, me Kinën në lindje, me Afganistanin në jug, dhe me Uzbekistanin në perëndim.

Vendi ka një sipërfaqe prej 143.100 km², dhe një popullsi prej 10.006.689 banorësh (Gusht, 2022, sipas worldometers.info).

Kryeqyteti dhe qyteti më i madh i Taxhikistanit është **Dushanbe**.

GJEOGRAFIA

Taxhikistani është një vend pa dalje në det, dhe është shteti më i vogël i Azisë Qendrore për nga sipërfaqja. Vendi është i mbuluar nga malet e vargmalit të Pamirit, dhe pjesa më e madhe e Taxhikistanit gjendet në lartësinë mbi 3.000 metra mbi nivelin e detit. Ulhtësirat kryesore të vendit gjenden në veri të tij (pjesë të luginës së Ferganës), dhe në jug të luginave të lumenjve Kofarnihon dhe Vakhsh, të cilët formojnë lumin Amu-Darja. Dushanbe shtrihet në shpatet jugore, mbi luginën e Kofarnihonit.

Lumenjtë Amu-Darja dhe Panj shënojnë kufirin me Afganistanin, dhe akullnajat në malet e Taxhikistanit janë burimi kryesor i ujërave të Detit Aral. Në Taxhikistan ka mbi 900 lumenj më të gjatë se 10 kilometra.

Rreth 2% e sipërfaqes së vendit është e mbuluar nga liqenet, më të njohurit prej të cilëve janë: Iskanderkul, Kulikalon, rezervuari Kajrakum, rezervuari Nurek, etj.

Taxhikistani përmban pesë ekorajone tokësore: Stepën Alai në perëndim të maleve Tian Shan, pyjet e hapura Gissaro-Alai, shkretëtirën dhe tundrën alpine të Pamirit, gjysmë-shkretëtirat Badgiz dhe Karabil, dhe pyjet Paropamisus.

KLIMA

Klima e Taxhikistanit është kontinentale e theksuar, që ndryshon sipas lartësive. Në zonat e luginës së ngrohtë dhe të butë, vera është e nxehtë dhe e thatë. Temperatura mesatare në Korrik sillet rreth 27 °C në veri, dhe rreth 30 °C në jug. Shifrat respektive të janarit janë përkatësisht -1 °C dhe 2

°C. Gjatë dimrave shumë të ftohtë janë regjistruar temperatura prej -20 °C, madje edhe më të ulëta. Reshjet vjetore atje janë të pakta, dhe variojnë mes 150 - 250 milimetra.

Në malësi të Taxhikistanit kushtet klimatike janë ndryshe: Temperatura mesatare e janarit në Murgob, në malet Pamir është -20 °C, dhe mund të zbrësë deri në -46 °C. Në këtë zonë reshjet mezi arrijnë 50-75 milimetra në vit, dhe shumica e tyre bien në verë. Masa ajri të lagështa lëvizin nga perëndimi drejt luginave, duke arritur papritur në zonat me temperaturë të ulët dhe duke shkaktuar reshje të dendura lokale, kryesisht borë të dendur, që shkon deri në 75 - 150 cm trashësi.

karbonatet, fluoritin, arsenikun, rërën e kuarcit, asbestin, etj. Zona kryesore e minierave është në veri të vendit. Minierat e qymyrit dhe nxjerrja e naftës janë ndër industritë më të vjetra në vend. Nxjerrja e gazit natyror atje filloi në mesin e viteve 1960, në Kyzyl-Tumshuk dhe në fushat pranë Dushanbe.

Burimet energjetike përfshijnë depozita të konsiderueshme qymyri, dhe rezerva më të vogla të gazit natyror dhe naftës. Taxhikistani është ndër vendet me potencialin më të madh për energji hidroelektrike në botë, dhe shumica e energjisë elektrike të prodhuar në Taxhikistan është hidroelektrike.

Bujqësia ende udhëheq industrinë



EKONOMIA

Ekonomia e Taxhikistanit varet kryesisht nga bujqësia dhe shërbimet, ku secili nga këta dy sektorë punësojnë më shumë se dy të pestat e fuqisë punëtore. Lufta civile që pasoi pavarësinë e Taxhikistanit pati një ndikim shkatërrues për bujqësinë dhe industrinë në vend.

Taxhikistani ka depozita të pasura me minerale si hekuri, plumbi, zinku, antimoni, mercuri, ari, kallaji dhe tungsteni. Minerale të jometalike përfshijnë kripën e zakonshme,

për nga rëndësia në ekonominë e Taxhikistanit, dhe rritja e pambukut i tejkalon të gjitha kategoritë e tjera të bujqësisë së vendit. Degë të tjera të rëndësishme të ekonomisë përfshijnë blegtorinë dhe kultivimin e frutave, drithërave dhe perimeve. Fermerët e Taxhikistanit kultivojnë grurë dhe elb, siç kanë edhe zgjeruar kultivimin e orizit. Hortikultura ka qenë e rëndësishme në territorin e Taxhikistanit që nga lashtësia. Atje prodhohen kajsi, dardha, mollë, kumbulla, ftonj, qersh, shegë, fiq dhe arra. Vendi eksporton bajame, kajsi të thata dhe rrush.

KRYEQYTETI, DUSHANBE



GJUHA

Gjuha taxhike është gjuha zyrtare në Taxhikistan, dhe flitet nga shumica e banorëve të vendit. Rusishtja përdoret gjerësisht për administratë dhe biznes, por pak e flasin atë në vend. Uzbekishtja është gjuha e dytë më e folur, dhe shkruhet në alfabetin cirilik, ndryshe nga çfarë ndodh në Uzbekistan ku uzbekishtja shkruhet me një alfabet latin të modifikuar.

FEJA

Shumica dërmuese e banorëve të Taxhikistanit (rreth 96.7 %) janë myslimanë, kryesisht të shkollës sunite Hanefi. Popullsia e krishterë atje ka qenë kryesisht ruse, por që nga shpërbërja e Bashkimit Sovjetik shumica e rusëve etnikë janë larguar.

HISTORI

Taxhikët janë pasardhës të drejtpërdrejtë të popujve iranianë,

prania e vazhdueshme e të cilëve në Azinë Qendrore dhe në Afganistanin verior, dëshmohej nga mesi i mijëvjeçarit të parë, para erës sonë. Paraardhësit e taxhikëve përbënin bërthamën e popullsisë së lashtë të Khavarizm-it dhe Baktria-s, të cilat ishin pjesë të Transoksaniës së lashtë. Ata u përfshinë në perandoritë e Persisë dhe të Aleksandrit të Madh, dhe u ndërthurën me pushtues të tillë të mëvonshëm si Kushanët dhe Heftalitët (në shekujt 1-6 të e.s.).

Pushtimi i Azisë Qendrore nga muslimanët arabë, që filloi në mesin e shekullit të 7-të, solli Islamin në rajon. Më pas, me ngritjen e Samanidëve (819-999), taxhikët ranë nën sundimin e tyre. Pushtuesit e parë turq (që erdhën nga verilindja) e pushtuan këtë zonë të Transoksaniës në vitin 999, dhe për shkak se të dyja palët - të pushtuarit dhe pushtuesit - ishin myslimanë, me kalimin e kohës shumë taxhikë,

veçanërisht ata në luginat e Syr Darja dhe Amu-Darja, u turqizuan. Kjo rezultoi në transformimin e një toke dikur thjesht iraniane, në "Turkistan". Emri Taxhik, që fillimisht iu dha arabëve nga popullsia vendase, filloi të aplikohet nga sundimtarët turq për ata elementë të popullsisë që vazhdonin të flisnin gjuhët iraniane.

Deri në mesin e shekullit të 18-të, Taxhikët ishin pjesë e Emiratit të Buharasë, por më pas afganët i pushtuan zonat në jug dhe jugperëndim të Amu-Darja-s, që banoheshin nga taxhikët, përfshirë qytetin e Balkhut i cili ishte një qendër e lashtë kulturore Taxhike.

Pushtimet ruse në Azinë Qendrore, në vitet 1860 dhe 1870, sollën një numër taxhikësh në luginat Zeravshan dhe Fergana, nën qeverisjen e drejtpërdrejtë të Rusisë, kurse në vitin 1868, Emirati i Buharasë u bë një protektorat rus.

Pas Revolucionit Rus të vitit 1917, një pjesë e konsiderueshme e popullit

XHAMIA E MADHE, DUSHANBE





Xhamia Shejh Muslihadin,
Kuxhand, Taxhikistan (shek.12)

taxhik u përfshi në A.S.S.R e Turkestanit (Republika Socialiste Sovjetike Autonome e Turkestanit), e themeluar në Prill të vitit 1918.

Në vitin 1929, statusi i A.S.S.R. e Taxhikistanit u ngrit në atë të një "Republike Socialiste Sovjetike". Ndryshimi i statusit shënoi herën e parë që populli Taxhik kishte shtetin e tij, megjithëse jo plotësisht të pavarur, pasi ishte ende pjesë e Bashkimit Sovjetik.

Shpërbërja e Bashkimit Sovjetik në vitin 1991 çoi në shpalljen e pavarësisë së Taxhikistanit më 9 Shtator, të vitit 1991.

SI ERDHI ISLAMI NË TAXHIKISTAN

Ardhja e Islamit në këtë rajon është e lidhur me marrjen e Horasanit dhe

Transoksinës nga luftëtarët muslimanë arabë. Pas betejës së Kadisijes, Islami e shtriu ndikimin e tij deri në Persi, arriti deri në lumin Xhejhun, pastaj depërtoi në rajonin e Luginës Ferghana. Në periudhën ndërmjet viteve 94-96 të hixhretit, komandanti Kutejbe ibn Muslim mori Luginën Ferghana dhe kaloi përtej saj në drejtim të lindjes, derisa arriti në kufijtë e Kinës. Më pas ai mori Kashgar-in. Pas një sërë fitoresh, Kutejbe ibn Muslim u kthye, dhe vendin e tij e zuri vëllai i tij Salih ibn Muslim, i cili vazhdoi luftimet për marrjen e pjesës së mbetur të Luginës Ferghana. Pasi Kutejbe ibn Muslim u kthye në Merv, vëllai i tij Salih ibn Muslim El-Bahilij arriti të merrte Kashan-in dhe Oresht-in, në Luginën Ferghana, dhe përhapja e Thirrjes Islame vazhdoi gjatë

gjithë epokës Umejade.

Në epokën abaside, lidhjet e kalifëve abasidë me Persinë, Khorasanin dhe Azinë Qendrore u forcuan. Thirrja Islame lulëzoi gjatë epokës së Samanidëve. Pas Samanidëve, në pushtet erdhën Gaznavidët, që edhe këta u treguan besnikë ndaj Thirrjes Islame, veçanërisht gjatë epokës së Mahmud Gaznavi, i cili i zgjeroi kufijtë e shtetit të tij islam deri në Indi.

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, teologe

<https://www.worldometers.info>
<https://www.britannica.com>
<https://en.wikipedia.org>
<https://www.marefa.org>
<https://www.islamstory.com>

DUSHANBE



Agim Baçi, gazetar

Këto dallime binare, sipas Stossit, por edhe sipas filozofit Michel Foucault, bëhen me qëllim nga debatuesit më së shumti për dominimin dhe nënshtrimin e tjetrit që është ndryshe kulturalisht nga ai. Edhe në rastin e debatit për shaminë, që nisi në Prishtinë e u zhvendos në Tiranë e në Shkup, kjo tendencë binare, për të futur myslimanët në territorin e inferioritetit, ka qenë ndoshta problemi më thelbësor i debatuesve, sidomos në rrjetet sociale.

Më së pari më duhet të themi se në të gjithë këto vite që është ndezur ky debat i përsëritur rreth mbajtjes apo jo të shamisë në institucione publike, destinacioni duket se nuk ka qenë aspak shqetësimi për tjetrin, por dëshira për të tentuar një epërsi kulturore. Një tendencë e tillë thjesht ka tentuar një getoizim apo nënshtrim të atij që e sheh botën ndryshe dhe që nuk dëshiron të jetë peng i spektaklit, i modës. Madje, nuk mungojnë as ngjyrat e debatit mbi shaminë dhe mjekrën, të gërshetuara me bakllavanë, kadaifin e tullumbat, athua se njeriu pasi heq mjekrën dhe shaminë dhe në vend të bakllavasë ha tiramisun apo çizkejk, direkt mençurohet, i vjen vështrimi i duhur për këtë dynja!

Një hile banale dhe tinëzare nga debatuesit është zhvendosja e diskutimit me slogane të tilla si: "Ne jemi si Evropa", apo "e ardhmja jonë është Perëndimi", dhe se "ne jemi oksidentalë e jo orientale", edhe pse shumë prej tyre nuk do dinin të shpjegonin se nga kanë ardhur përkufizime të tilla dhe se çfarë nënkuptojnë këto koncepte. Madje, këta debatues i rreshtojnë argumentimet e tyre pa rrëfyer aspak se këto shoqëri që ata shembullojnë për idetë e tyre, i kanë zgjidhur këto çështje duke

SHAMIA DHE IMAGJINARJA NAIVE E SUPERIORITETIT!

Një hile banale dhe tinëzare nga debatuesit është zhvendosja e diskutimit me slogane të tilla si: "Ne jemi si Evropa", apo "e ardhmja jonë është Perëndimi", dhe se "ne jemi oksidentalë e jo orientale", edhe pse shumë prej tyre nuk do dinin të shpjegonin se nga kanë ardhur përkufizime të tilla dhe se çfarë nënkuptojnë këto koncepte.

shmangur paragjykimin se si dihet të vishet dikush në përditshmërinë e tij edhe pse myslimanët janë emigrantë në këto vende që ata marrin si shembull. Ndërkohë që në tokat tona të shqipes ky debat shtrembërohet qëllimisht, duke tentuar gjithnjë e më shumë që mos të kërkojë një zgjidhje në respekt të besimit të tjetrit, por që më së shumti të krijojë mendimin binar "ne të zhvilluar- ata të prapambetur".

Por, si është e mundur që askush nga kundërshtuesit e mbajtjes së shamisë nuk mund të vërtetojë se nëse vishesh apo zhvishesh si ata, direkt merr një qytetari tjetër, të mbulon një mençuri dhe siguri për jetën dhe se e kupton tjetrin më mirë? Apo i gjithë ky debat ka në thelb dërgimin e komuniteteve besimtare në periferi të shoqërisë, me


jetën burokratike të komunitetit të besimtarëve, në Prishtinë, në Tiranë e në Shkup, mbajnë përgjegjësinë për të shpjeguar vlerat e asaj çka përfaqëson shamia apo shumë rregulla që besimtarët ndjekin në përditshmërinë e tyre. Ata duhet të shpjegojnë se demokracia nuk bie në kundërshtim me besimin, por sidomos me detyrën për të kërkuar diturinë.

Vetë besimtarët e dinë se sa e rëndësishme është ta fitosh betejën në shoqëri duke debatuar me të tjerët, duke treguar vlerat në bashkëjetesë me të tjerët, e jo duke u veçuar dhe duke u strukur në vetminë që tashmë u ofrohet me bollëk nga projektuesit dhe sugjeruesit e territoreve inferiore për besimtarët. Vetëm myslimanët shqiptarë

e kanë në dorë që të mos lejojnë që ndaj tyre të ndërtohen getot e rrezikshme të territorit të inferioritetit, që mund të jetë më së paku një ngarkesë sociale për shoqërinë, ose një argument dashakeqës ndaj atyre që dëshirojnë t'i shohin besimtarët si pikturë e keqe, që nuk mund të ekspozohemi në rrugëtimin tonë si shoqëri.

E duke marrë shkas nga ky debat, ne duhet të pohojmë se në këtë proces të pandalshëm të ndërveprimit kulturor, ne duhet që të shqetësohemi se po mbështesim një shoqëri hipokrite, një shoqëri që ka humbur nervin për të ndëshkuar të padrejtin, hajdutin dhe të fortin që kërkon të sfidojë ligjin. Ne duhet të shqetësohemi se brezi i sotëm në shkollë është një analfabet funksional, që nuk ka më respekt për të

ndershmin, që nuk shqetësohet se si të jetë i ndershëm, por që ka qëllim se si të pasurohet brenda ditës dhe se si të jetë në rrethin e përditshëm të famës. Dhe në këtë rrugëtim nuk të ndihmon zhveshja, ashtu siç nuk është as garanci se me vënien e shamisë ke fituar legjitimitetin e një qytetari të përgjegjshëm për veten e më pas edhe për komunitetin ku jeton.



VETËM MYSLIMANËT SHQIPTARË E KANË NË DORË QË TË MOS LEJOJNË QË NDAJ TYRE TË NDRËTOHEN GETOT E RREZIKSHME TË TERRITORIT TË INFERIORITETIT, QË MUND TË JETË MË SË PAKU NJË NGARKESË SOCIALE PËR SHOQËRINË, OSE NJË ARGUMENT DASHAKEQËS NDAJ ATYRE QË DËSHIROJNË T'I SHOHIN BESIMTARËT SI PIKTURË E KEQE, QË NUK MUND TË EKSPOZOHEMI NË RRUQËTIMIN TONË SI SHOQËRI.

qëllim që të mbretërojë vetëm spektakli dhe vaniteti?

Ndërkaq, duhet të pohojmë se vetë myslimanët nuk duhet t'i shmangen përgjegjësisë për dialogun në publik, për t'iu treguar anëtarëve të shoqërisë ku jetojnë thelbin e asaj çka ata besojnë, që të mos jenë thjesht objekt për lajm negativ. Ata që drejtojnë



Amir B. Ahmeti
Jurist, Prishtinë

Një sqarim mbi termat 'laik' dhe 'sekular' dhe çfarë drejtimi po merr Kosova në raport me fenë.

Duke analizuar debatet e shumta të dy-tri javëve të fundit rreth disa çështjeve fetare, iu qasa seriozisht punës për të hulumtuar burimin e kësaj enegjie negative të disa politikanëve dhe pseudointelektualëve ndaj religjionit. Ata, në mënyrë direkte apo indirekte dhe jo rrallëherë kanë fyer ndjenjat fetare të besimtarëve në vendin tonë.

Antiteizmi i tyre shprehet qartë, veçanërisht kundër islamit dhe sa herë sulmojnë religjionin, prijësit fetarë ose besimtarët, fshihen prapa nenit 8 të Kushtetutës së Kosovës e cila përcakton Kosovën si vend laik. Ndërsa nëse i pyet ata se çka nënkupton me termin laik, laicitet apo laicizëm; se kur është përmendur për herë të parë kjo fjalë; ose nëse e dinë kuptimin etimologjik dhe terminologjik të saj; stepesh nga injoranca e tyre, ngase ballafaqohesh me pseudointelektual të mentalitetit marksisto-leninist që nuk dinë dhe nuk duan të dinë por vetëm fyejnë, madje edhe me barriera të ndryshme mundohen të pengojnë besimtarët për të praktikuar besimin e tyre.

Këto qëndrime i kemi trashëgim nga sistemi i kaluar, por tani që po ndërtojmë institucione demokratike është e udhës mos të ndjekim hijet e venitura të komunizmit i cili konsideronte fenë opium e shkaktare të të gjitha të këqijave. Pra të mos lejojmë që edhe sot dikush t'i jap të drejtë vetes që në emër të shtetit të dhunojë të drejtat fetare.

Kjo trashëgimi nga sistemi i kaluar po na kushton çdo ditë e më shumë. Madje edhe në kushtetutën e parë të Kosovës së pavarur dhe demokratike nuk kemi mundur t'i ikim kësaj trashëgimie. Ndër tjera kemi edhe

KOSOVA: SHTET LAIK, SEKULAR APO ATEIST?

Për të njohur kuptimin e laicitetit e sekularizmit dhe dallimit ndërmjet tyre është shumë e rëndësishme të dimë etimologjinë e këtyre dy fjalëve. Kur u përdorën për herë të parë? Për çfarë arsye? Çka ngërthejnë në vete dhe sidomos të njohësh terminologjinë e tyre nga vetë përdoruesit, sepse kjo e definon edhe kuptimin e sotëm të dy fjalëve/termeve.

provizionin kushtetues që lirisht mund të cilësohet si tendencioz, sidomos për mënyrën se si është përpiluar. Fjalën e kam për nenin 8 të kushtetutës së Kosovës i cili përcakton vendin tonë si vend laik: “Republika e Kosovës është shtet laik dhe neutral në çështje të besimeve fetare.”

Ky provizion kushtetues konsideroj se nuk është i përshtatshëm as përafërsisht me traditën dhe kulturën e vendit tonë dhe duke u bazuar në praktikën evropiane për pozitën dhe respektin e veçantë që gëzon religjioni në vendet e BE-së, e sidomos trajtimit të fesë si vlerë e patjetërsueshme e qytetarëve të secilit vend, është një shembull i mirë për vendin tonë, aspiruese e integritetit evropian, që

ËSHTË INTERESANT SE ASNJË VEND EVROPIAN, PËRVEÇ FRANCËS, AS ATO ANËTARE TË BE-SË E AS ATO NGA RAJONI, NUK PËRCAKTOJNË ME KUSHTETUTË SE JANË SHTETE LAIKE. E KUR CEKA MË HERËT SE GJATË STUDIMIT BEFASIE ISHTE EDHE MË E MADHE, E KISHA FJALËN SE ASNJËRA NGA KËTO VENDE NUK ISHIN TË PËRCAKTUARA AS SI SHTETE SEKULARE, PËRVEÇ SERBISË. E REZULTATI DEL SE VETËM DY VENDE ME KUSHTETUTË PËRCAKTOHEN SI SHTETE LAIKE, FRANCA DHE KOSOVA, SERBIA PËRCAKTOHET SI SEKULARE, E TË TJERAT AS NUK E PËRMENDIN FARE NË KUSHTETUTAT E TYRE KËTË PËRCAKTIM!!!

të ndryshohet çasja institucionale e Kosovës karshi besimit/religjionit të qytetarëve të vet. Kjo më së miri shihet në kushtetutat e secilit vend të BE-së, veç e veç.

Pra, duke u bazuar në të gjitha kushtetutat e vendeve anëtare të BE-së, gjejmë një çasje shumë pozitive se si është e trajtuar feja e qytetarëve të secilit vend dhe si qëndrojnë raportet ndërmjet shtetit dhe fesë së atij vendi apo të komuniteteve tjera fetare. Këto kushtetuta përcaktojnë mënyrën e ndërtimit të raporteve të shtetit me bashkësitë fetare në bazë të respektit të ndërsjellë të autonomisë së tyre si dhe të pavarësisë së secilit në sferën e vet. Po ashtu se kultet fetare duhet të jenë të pavarura nga shteti por njëherit të kenë edhe përkrahje nga ai, duke përfshi edhe asistencën fetare në ushtri, spitale, burgje, etj. Ndërsa asgjë prej këtyre përkufizimeve nuk i gjejmë në kushtetutën e vendit tonë!

Vazhdova analizën time që pas përfundimit të saj t'i propozoja komisionit për ndryshimet kushtetuese amandamentimin e këtij neni të kushtetutës, ose që komisioni për legjislacion të jap vlerësimin vet. Këtë e bisedova edhe me disa kolegë deputet të Kuvendit të Kosovës, me propozimin se termi 'laik' do të ishte mirë të zëvendësohej me atë 'sekular'. Por, pas përfundimit të hulumtimit dhe analizës sime rezultatet e nxjerra tejkalonin pritjet e mia.

Kështu para se të filloja përpilimin e propozim-amendamentit duke shpresuar se ndryshimi i këtij provizioni kushtetues do të ndryshonte edhe qasjen e shumë njerëzve ndaj religjionit, fillimisht i hulumtova dhe analizova termet 'laik' dhe 'sekular'.

Edhe pse mendohet se janë shprehje me të njëjtin kuptim ato dallojnë shumë në esencë. Kështu, për të njohur kuptimin e laicitetit e sekularizmit dhe dallimit ndërmjet tyre është shumë e rëndësishme të dimë etimologjinë e

këtyre dy fjalëve. Kur u përdorën për herë të parë? Për çfarë arsye? Çka ngërthejnë në vete dhe sidomos të njohësh terminologjinë e tyre nga vetë përdoruesit, sepse kjo e definon edhe kuptimin e sotëm të dy fjalëve/termeve.

Ndërsa te ne në Kosovë, laiciteti, nga disa politikanë e pseudointelektual, po definohet si diçka dominuese mbi fenë, sikur ajo po iu lejon atyre që të demonizojnë fenë. Por, definicionet e tyre nuk kanë kurrfarë baze dhe janë sa tendencioze po aq edhe cinike. Me këto definicione thumbuese, ata po mohojnë shumë të drejta fetare për besimtarët në emër të laicitetit. Tek e fundit, ndarja e fesë nga shteti nuk do të thotë që shtetit t'i lejohet të dhunojë të drejtat fetare ose të diskriminojnë besimtarët.

Laiciteti si terminologji, përmendet kah fundi i shekullit XIX-të në Francë si përpjekje për të shmangur apo larguar ndikimin e kishës mbi institucionet publike dhe në vitin 1905 merr trajtën ekzekutive me ligjin e ndarjes së kishës nga shteti. Ndërsa krejt e kundërta, sekularizmi, ka ardhur në shprehje si mënyrë e ndarjes së shtetit nga feja, për të mbrojtur besimtarët nga persekutimi shtetëror, siç ka qenë rasti i protestantëve në fillimin e përhapjes së tij.

Atëherë, pse Kosova të veçohet me një provizion të tillë kushtetues, duke shtuar se edhe vendet nga regjioni, asnjëra nuk janë përcaktuar i vende laike, as edhe shteti amë Shqipëria. Por sa më shumë që thellohesha në studimin e kësaj teme befasia ishte edhe më e madhe..

Është interesant se asnjë vend evropian, përveç Francës, as ato anëtare të BE-së e as ato nga rajoni, nuk përcaktojnë me kushtetutë se janë shtete laike. E kur ceka më herët se gjatë studimit befasia ishte edhe më e madhe, e kisha fjalën se asnjëra nga këto vende nuk ishin të përcaktuara as si shtete sekulare, përveç Serbisë. E rezultati del se vetëm dy vende me kushtetutë përcaktohen si shtete laike, Franca dhe Kosova, Serbia përcaktohet si sekulare, e të tjerat as nuk e përmendin fare në kushtetutat e tyre këtë përcaktim!!!

Aq më tepër sipas kushtetutave të vendeve më të zhvilluara evropiane, feja është pjesë përbërëse e shtetit, si në rastin e Britanisë së Madhe, Suedisë, Danimarkës, Norvegjisë (edhe pse jo anëtare e BE, e kam marrë shembull si vend mjaft i zhvilluar), etj.

P.sh. në Britani të Madhe Mbretëresha bashkon pushtetin politik dhe atë fetar njëherësh duke qenë edhe mbretëreshë e vendit edhe shefe supreme e kishës angleze, e poashtu çdo mbret apo mbretëreshë detyrimisht duhet të jenë të besimit protestant. Njëherit, peshkopët e kishës Angleze, kanë ulëse të rezervuara në Dhomën e Lordëve të cilat vende iu takojnë pa qenë të votuar.

Po ashtu edhe në Suedi kemi situatë të ngjashme ku me aktin e suksesionit mbreti duhet t'i takoj rendit Lutheran (të krishterimit). Ndërsa në Danimarkë, neni 4 i kushtetutës përcakton se Kisha Ungjillore Lutheriane është kisha e shtetit dhe si e tillë, ajo do të mbështetet nga shteti. Kurse neni 6 specifikon fenë e mbretit i cili duhet të jetë anëtar i Kishës Ungjillore Lutheriane. Situatë të ngjashme kemi edhe në Norvegji ku neni 4 i kushtetutës përcakton se mbreti duhet të jetë i besimit Evangjeliko-Lutherian dhe neni 16 përcakton Kishën Norvegjeze dhe Kishën Evangjeliko-Luteriane si kisha të shtetit. Është interesant se asnjëra nga këto vende demokratike nuk shquhen si teokratike edhe përkundër përcaktimit fetar të shtetit, sepse feja është vlerë e qytetarëve të secilit vend. Vallë, pse te ne duhet të kuptohet feja ndryshe nga vendet tjera.

Besoj nuk e teproj me mëdyshjen time kur e shtroj pyetjen: Kah po shkon Kosova? Dhe a është kjo një përpjekje që gradualisht Kosovën ta shpien kah ateizmi?! Nëse jo atëherë: Përse politikanët tanë para pesë viteve zgjedhën pikërisht variantin e shtetit të vetëm evropian që Kosovën ta quajnë shtet laik, e kjo mendoj ka ndodhur pa i shikuar rrethanat të cilat kanë çuar Francën që t'i përmbahet asaj shprehje dhe pa krahasuar me rrethanat dhe traditën e vendit tonë. Madje është përdorur edhe një hile juridike gjatë përpilimit të kushtetutës. Në versionin anglisht dhe serbisht Kosova është përcaktuar si 'shtet sekularë' ndërsa në versionin shqip 'shtet laik'. Tani që dallimin e këtyre dy termave e bëmë të qartë është normale por dhe kam të drejt të shqetësohem. Pse ndodhi kjo, rastësisht apo qëllimisht?! Nuk besoj se rastësia ndodhë kur përpilohet një dokument kaq i rëndësishëm.

Amir B. Ahmeti është magjistër i shkencave juridike, dhe ish-deputet i pavarur në Kuvendin e Kosovës.

(www.observer.al)



Dr. Khalid Sheldrake
(Bertie William Sheldrake)
Londër, 1888 - 1947

“

E PYETA VETEN:
NËSE ISLAMI NUK KA ASNJË RËNDËSI, ATËHERË PËRSE PERËNDIMORËT SHPENZOJNË TËRË KËTO PËRPPJEKJE PËR TA NDALUAR?!

UNË NUK KAM ASNJË PIKË DYSHIMI, SE ISLAMI DO TA SUNDOJË MBARË BOTËN, POR ME KUSHT QË:

MYSLIMANËT TË JENË SHEMULL I PËRSOSUR NË PREZANTIMIN E ISLAMIT DHE NJOHJEN E POPUJVE TË TJERË ME TË, NË MËNYRË PRAKTIKE!"



KANCERVATORI!

Kancervatorizmi është arsye e mjaftueshme, e natyrisht jo e vetmja, që politikisht shqiptarët ta vijnë vegjetimin në stadin e popullsisë. As të popullit jo, e le më të kombit.

Një nënloj social, i shumëzuar në humusin e metanarrativave me tradita, vlera të djathta, bëma epike apo orientime euro-atlantike, është edhe kancervatori. Manifestohet me profile të ndryshme, teorikisht të djathta, plot eksperiencë ngashënyese, që variojnë nga altoparlanti mediatik, te këshillimi i presidentit, posti akademik, partiak, parlamentar e me radhë. Dje ndeshej i pagëzuar nga Partia me emër ilir, sot zbulohet me emër a mbiemër apostolik. Në çdo rast, në raport me publikën mbetet një nënloj metastatik. Çfarë është?

Kancervatori është gjëkafshë tribale. Rreth tij ekziston vetëm tufa.

Kancervatori s'do dhe s'mund të jetojë në polis, në bashkësinë e të ndryshmeve. Kur i lejohet, ai di vetëm ta mësyjë polis-in, t'i imponohet, të kërkojë.

Kancervatori ndodhet në komb falë koordinatave juridike ose nevojave rastësore të mbijetesës së tufës, porse nuk i përket atij, sepse përkatësia kombëtare ndërtohet mbi marrëdhënie, kontratë e konvencione.

Kancervatori i mshon fesë për të refuzuar Tjetrin dhe për t'u njësuar me tufën, sepse feja tek ai nuk lulëzon si besim.

Kancervatori s'ka shtyllë kurrizore. Fashizmi i përshtatet mirë. Shkon rrugëve në tufë (reale, imagjinare a simbolike). Guxon përherë si zëdhënës

i një liste autoritetesh (individuale a institucionale).

Kancervatori i ngjitet pemës sapo ndjen rrezikun dhe pasi është siguruar mirë zbret për të shenjuar territorin. Kur nuk ka pemë, merr formën e çdolloj ene që do pushteti, dhe sapo ky i fundit ndrron, ai bëhet profet i Zotit që deri dje ka pështyrë.

Kancervatori është tregtar i shkëlqyer: hipjen në pemë dhe zbritjen për shërbime i shet për qëndresë; ruan gjithashtu me zili monopolin e viktimizimit.

Kancervatori noton në ujëra të cekëta dhe pluskon me rrjedhën. S'ka individualitet, nuk sjell risi, mbetet tufë.

Kancervatori s'ka ideale. Ngjan si i idealist vetëm kur i bën hesapet keq.

Kancervatori operon ekskluzivisht me racionalitet ekonomik dhe asnjëherë me racionalitet aksiologjik. Është koherent ekskluzivisht me dhe për interesin.

Kancervatori flet dhe zgërdhiet vetë. Nuk njih ironi, veç cinizëm.

Kancervatori s'ka masë. Ndonëse arsyeja e dallon nga kafsha, mungesa e masës ia pamundëson humanizimin.

Kancervatorizmi është arsye e mjaftueshme, e natyrisht jo e vetmja, që politikisht shqiptarët ta vijnë vegjetimin në stadin e popullsisë. As të popullit jo, e le më të kombit.

(burimi: fb - Post Bllok)



Pejgamberi (a.s) ka thënë:

“Kur njerëzit
ta shohin
zullumqarin
dhe mos ta ndalojnë
nga padrejtësia e
tij, mund
të përfshihen
nga ndëshkimi
i All-llahut!”



(Transmetuar nga Ebu Davudi,
Tirmidhiu dhe Ibn Maxheh)

MEJTEPI I IM... XHAMIA E LAGJES DUDAS

PAK HISTORI:

- Xhamia Dudas, ndodhet në Njësinë Administrative të Qytetit të Shkodrës, dhe ndodhet në një nga lagjet më vjetra të qytetit me të njëjtin emërtim, Dudas.

- Aktualisht, përbëhet prej rreth 900 familje myslimane.

- Familjet më të njohura janë: Bala, Drishti, Lluja, Kraja, Lici, Omaraj, Repishti, Halili, Kali, Kuçi, etj.

- Xhamia e re e lagjes Dudas është ndërtuar në qershor të vitit 2015, në të njëjtin vakëf ku ka qenë xhamia e vjetër, e shkatërruar në vitin 1968 nga sistemi barbar komunist. Përbri xhamisë gjendet edhe mejtepi.



- Imamët dhe mësuesit e mejtepeve që kanë shërbyer në këtë xhami, pas hapjes së xhamisë, nga viti 2015 e në vazhdim janë: Adrian Uraj, Vehbi Dani dhe imami aktual, Samel Haxhia.

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 6 kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në xhami në periudha të ndryshme nga viti 2015-2022 është rreth 90 nxënës dhe nxënëse.

TAKIMI ME NXËNËSIT:


Në vazhden e vizitave dhe takimeve të sektorit të arsimit pranë Myftinisë Shkodër me nxënësit e xhamive që frekuentojnë kurset/mejtepet e mësim-

besimit, drejtuesi dhe inspektori i arsimit, teologu Arben Halluni zhvilloi një takim me nxënësit e kursit fetarë në xhaminë Dudas.

Teologu Halluni, pasi u njoh me ecurinë e procesit mësimor, zbatimin e programit, pjesëmarrjen e nxënësve etj, u mbajti një bisedë, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin në përcimin te brezi i ri të mësimave të vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo besimtar në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit.

Në këtë takim ishte edhe mësuesi i kursit fetar z. Taksim Plori.

XHAMIA DUDAS



“FEJA ËSHTË KËSHILLË” LIGJËRATA E RADHËS E MYFTIUT TË SHKODRËS



Ditën e mërkurë, pas namazit të akshamit në xhaminë të Ura e Bunës, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, në kuadër të ciklit të ligjëratave me temë: “Feja është këshillë”, mbajti ligjëratën e radhës në oborrin e kësaj xhamie, përpara besimtarëve të pranishëm.

Fillimisht, Myftiu ngushëlloi prindërit dhe familjarët e vajzës së vogël, e cila vdiq në mënyrë tragjike, duke u përplasur nga një gomone në plazhin e Himarës.

Ai theksoi, se sonte gjëja më e mirë, që mund të bëjmë është të lutemi për familjen e kësaj vajze të vogël dhe të lutemi për mbarë popullin shqiptarë, për shkak të kllapisë së madhe, që ka përfshirë mbarë vendin tonë. Individi jonë është hutuar dhe ne duhet të reagojmë, jo thjeshtë përmes rrjeteve

sociale, por të reagojmë, në atë mënyrë, që secili prej nesh të shikojë veten dhe çfarë raporti ka ai me të vërtetën dhe realitetin.

Në vazhdim të ligjëratës së tij, Imam Sytari u ndal tek një ngjarje dhe hadith i Pejgamberit (a.s) rreth fisit Himjer të Jemenit, ku i Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: “E mëshiroftë Allahu fisin Himjer, nga gjuhët e tyre del selami, nga duart e tyre del ushqimi; ata janë njerëz të besës dhe të besimit!”

Duke komentuar hadithin në fjalë, Myftiu theksoi se secili prej nesh duhet të stoliset me këto cilësi të vlefshme, në mënyrë që të përfshihet në lutjen e Pejgamberit (a.s) dhe të dëshmojë me vepra cilësitë e një muslimani të mirë dhe të përkushtuar.

Kjo ligjëratë u transmetua live në rrjetet sociale facebook dhe youtube.



MUHAMED SALAH RIPARON KISHËN NË EGJIPT

Aljazeera Sport

Lojtari egjiptian i futbollit, Muhamed Salah kontribuon me 3 milion xhunej egjiptian (156.686 \$) për riparimin e kishës ‘Ebu Sefin’, pas zjarrit të rënë në të.

Gazeta britanike ‘Mirror’, duke iu referuar kanalit Aljazeera Sports On time, tha se Muhamed Salah kontribuo me 3 milion xhunej për riparimin e kishës ‘Ebu Sefin’ në Giza.

Lista e kontribuuesve e publikuar nga ‘Sanday Times’ e ka vendosur Muhamed Salahin në vendin e 8-të, në mesin e personave me kontributin më të madh bamirës në Mbretërinë e Bashkuar për vitin 2022.



MYFTIU I SHKODRËS VIZITË NË BIBLIOTEKËN E QYTETIT



Ditën e hënë, më 29 gusht 2022, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari zhvilloi një vizitë në bibliotekën e qytetit, ku u prit nga drejtori i saj, z. Maxhid Cungu dhe ku së bashku zhvilluan një bisedë rreth vlerave që përmbajnë fondet e bibliotekës dhe në mënyrë të veçantë ekzemplarët e Fondit të Antikuarëve.

Bashkëbisedimi u ndal edhe rreth botës së librit, trashëgimisë së dijetarëve elitarë dhe domosdoshmërisë së ruajtjes së tabanit, përballë nihilizmit dhe komplekseve të panevojshme që ia shkurtojnë jetën historisë së qytetit tonë dhe traditave të tij.


Ndërkaq, Myftiu u njoh me aktivitetet e ndryshme që zhvillon biblioteka në ruajtjen, dixhitalizimin e librave dhe shërbimin ndaj lexuesve.

Nga profili i tij në facebook, Imam Muhamed Sytari shkruan: “Pata kënaqësi të konsumoj kafën e mëngjesit me drejtorin e bibliotekës së Shkodrës, të nderuarin z. Maxhid Cungu, me të cilin zhvilluam një bashkëbisedim të vyer rreth botës së librit, trashëgimisë së

dijetarëve elitarë dhe domosdoshmërisë së ruajtjes së tabanit, përballë nihilizmit dhe komplekseve të panevojshme që ia shkurtojnë jetën historisë së qytetit tonë dhe traditave të tij.

I dhurova librin tim të ri: “Meditime”, me shpresën e një kujtimi të mirë dhe lutjes në heshtje”.

Vizitën e Myftiut e publikoi edhe biblioteka e qytetit në profilin e saj në facebook, duke u shprehur: “Biblioteka ‘Marin Barleti’, pasurohet herë pas here me libra të rinj të cilët dhurohen nga vetë autorët. Kësaj radhe ishte vetë Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari i cili dhuroi disa kopje të librit të tij të ri “Meditime”. Myftiu i shoqëruar nga teologu z. Arben Halluni drejtues i arsimit, pranë Myftinisë, u prit nga drejtori i Bibliotekës z. Maxhid Cungu ku së bashku zhvilluan një bisedë rreth vlerave që përmbajnë fondet e bibliotekës dhe në mënyrë të veçantë ekzemplarët e Fondit të Antikuarëve. Myftiu u njoh gjithashtu me aktivitetet e ndryshme që zhvillon biblioteka në ruajtjen, dixhitalizimin e librave dhe shërbimin ndaj lexuesve”.



Shejkh Muhamed El-Gazali

“*Dikur, në shoqërinë tonë, prindërit ishin begati. Dilte burri nga shtëpia për në punë, dhe ai ishte i qetë, sepse prindërit e tij i luteshin Allahut për të. E, kur kthehej në shtëpi, pyetja e parë ishte për prindërit, pastaj sillej nga gruasja dhe fëmijët e tij! Ne kemi ndryshuar shumë, por për keq...!”*



Pejgamberi (a.s) ka thënë:



“Turpi është prej besimit!”

(Transmeton Muslimi)

“NËSE S'KE TURP, VEPRO ÇFARË TË DUASH!”

(Transmeton Buhariu)



myftiniashkoder1990



myftiniashkoder1990



myftiniashkoder1990

www.myftinia-shkoder.org

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër



MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org